


DCAF Qendra e Gjenevës
për Qeverisjen e
Sektorit të Sigurisë
20 VJETORI



VËSHTRIME DHE MËSIMET TË NXJERRA NGA REFORMAT E SEKTORIT TË INTELIGJENCËS NË KROACI

Nga Dragan Lozančić



Rreth DCAF

Qendra e Gjenevës për Qeverisjen e Sektorit të Sigurisë (DCAF) promovon qeverisjen e mirë dhe reformën në sektorin e sigurisë. Qendra kryen kërkime për praktikën e mira, inkurajon zhvillimin e normave të përshtatshme si në nivelin kombëtar ashtu edhe atë ndërkombëtar, bën rekomandime të politikave dhe ofron këshilla dhe programe ndihme brenda vendit. Partnerët e DCAF përfshijnë qeveritë, parlamentet, shoqërinë civile, organizatat ndërkombëtare dhe gamën e shërbimeve të sektorit të sigurisë, përfshirë ushtrinë, policinë, gjyqësorin, agjencitë e inteligjencës dhe shërbimet e sigurisë kufitare.

Na vizitoni në www.dcaf.ch

Rreth serisë së botimeve

Seria “RSS në praktikë në Evropë dhe Azinë Qendrore” përfshin raste studimore në të cilat praktikuesit e sektorit të sigurisë dhe drejtësisë reflektojnë rreth përvojave dhe ofrojnë vështrime personale për zbatimin e reformës në institucionet e sektorit të sigurisë në shoqëritë në tranzicion, me fokus të veçantë te Ballkani Perëndimor, Evropa Lindore, Kaukazi Jugor dhe Azia Qendrore. Punimet ofrojnë vështrime për sfidat dhe mundësitë brenda proceseve të reformës në sektorin e sigurisë dhe adresojnë interesat e praktikuesve, politikëbërësve dhe kërkuesve.

Rreth Autorit

Dr. Dragan Lozančić ka punuar si nëpunës civil qeveritar për gati tri dekada dhe ka mbajtur disa poste të larta në Republikën e Kroacisë, përfshirë postin e Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë Kombëtare të Mbrojtjes dhe Shpëtimit (2017 - 2018) dhe postin e Drejtorit të Agjencisë së Sigurisë dhe Inteligjencës (SOA) (2012-2016). Gjatë kohës së tij si Drejtor i SOA ai prezantoi sërë reformash të fuqishme, nxiti novacionet teknologjike dhe avancoi agjendën ambicioze të bashkëpunimit ndërkombëtar. Dr. Lozančić ka shërbyer gjithashtu në Ministrinë e Mbrojtjes të Republikës së Kroacisë për gati dy dekada dhe ka mbajtur disa poste të larta drejtuese, përfshirë emërimin nga qeveria në postin e Ndhmës Ministrit të Mbrojtjes, përgjegjës për politikën e mbrojtjes, planifikimin dhe çështjet e sigurisë ndërkombëtare.

Pikëpamjet dhe mendimet e shprehura në këtë punim janë të autorit dhe nuk pasqyrojnë medoemos politikën ose qëndrimin zyrtar të DCAF, SOA apo të Republikës së Kroacisë.

Falënderime

Dëshirojmë të falënderojmë anëtarët e këshillit redaktues të DCAF ECA për përkushtimin e tyre dhe kohën që i kushtuan shqyrtimit të këtij punimi.

Botues

Geneva Centre for Security Sector
Governance (DCAF)

Maison de la Paix
Chemin Eugene-Rigot 2E;
CH-1202 Geneva, Switzerland
Tel: +41 22 730 94 00

Dizajni

Rodrigo Amorim, DCAF Geneva

Vështrime dhe mësim të nxjerra nga Reformat e Sektorit të Inteligjencës në Kroaci

Nga Dragan Lozančić

Reformat e sektorit të inteligjencës u treguan të pakapshme në tranzicionet e hershme pas Luftës së Ftohtë në sisteme të demokracisë liberale dhe ekonomi të tregut të lirë. Disa ende po ballafaqoheshin me vështirësi dekada pas rënies së Murit të Berlinit¹. Për hir të korrektësisë, shumë nga shqetësimet e hershme kishin të bënin me përpjekjet për të mbrehur forcat e armatosura dhe reformimin e sektorit të mbrojtjes në përgjithësi. Larg vëmendjes dhe shpesh nën hijen e lëkundjeve të mëdha politike, shërbimet e sigurisë dhe inteligjencës dukej se nuk ishin prekur nga ndryshimet që po ndodhnin rreth tyre. Ata i ruajtën me shumicë, në mos të gjitha, zakonet e tyre të vjetra edhe në mijëvjeçarin e ri. “Është e vështirë të gjesh një vend ish-komunist në Evropën Lindore,” shkruan The Economist, “në të cilin shërbimet e inteligjencës dhe të sigurisë nuk janë të politizuara dhe kontraverse.”² Shpesh herë u deshën skandale publike që u shfaqën si kryetituj të lajmeve për të zbuluar se sa thellë të rrënjosura ishin këto probleme.

Ndjesia e të qenët mbi ligjin ishte karakteristikë famëkeqe e shërbimeve sekrete. Një nocion i tillë nuk është në pajtim me demokracinë liberale. Shëndeti i një demokracie varet shumë nga sundimi i ligjit dhe shërbimi i interesit publik. Mbyllja e kapitullit të tranzicionit tonë në demokraci pa një kulturë të llogaridhënies, mekanizma efektivë të mbikëqyrjes dhe masa mbrojtëse të ‘kompetencave të veçanta’ që janë ngulitur siç duhet, do të ishte naivitet i parakohshëm.

Trashëgimia jugosllave

Shërbimi i Sigurimit Shtetëror i ish-Jugosllavisë, ende i njohur më së miri me shkurtesën e tij të mëparshme ‘UDBA’, ishte një instrument famëkeq i pushtetit totalitar që shkonte përtej mandatit të tij zyrtar të sigurisë së brendshme (kundërzbulimit). Qëllimi i tij kryesor ishte të mbrojtë shtetin nga armiqtë e tij brenda dhe jashtë vendit. E mbërthyer midis Paktit të Varshavës dhe NATO-s dhe nën rrethim nga ndërlikimet e veta të brendshme, mbijetesa e ish-Jugosllavisë varej shumë nga një kapacitet efektiv i inteligjencës. Ndërsa shumë nga kërcënimet e perceptuara ishin me të vërtetë reale, disa mbase nuk ishin. Shërbimi i Sigurimit Shtetëror kishte selinë e tij qendrore federative në Beograd dhe degë administrative gjysmë-autonome në secilën nga republikat jugosllave. Duke pasur parasysht kufizimet e tij të përkulshme, ai ishte i pamëshirshëm dhe i paskrupullt në ndjekjen e misionit të vet. Ai shfrytëzonte me kënaqësi kompetencat e tij ‘të zgjerueshme’ të zbatimit të hetimeve, marrjes në pyetje, vëzhgimit të fshehtë dhe arrestimeve. Mënyra klandestine e operimeve të tij siguronte mbulesë të bollshme për abuzime, frikësime dhe tortura. Ai kishte krijuar një rrjet të gjerë informatorësh dhe kishte grumbulluar qindra mijëra dosje për qytetarët e vet. Ai ishte gjithashtu përgjegjës për dhjetëra rrëmbime dhe vrasje të disidentëve politikë, aktivistëve, grupeve opozitare dhe personave të tjerë që ishin çmuar armiq të shtetit. Kriminelët shpesh rekrutoheshin për të kryer punën e tij të ndyrë. Me shpërbërjen e ish-Jugosllavisë dhe tranzicionin në demokraci në fillimin e viteve 1990, Kroacia dhe republikat e tjera secila morën rrugën e vet, duke trashëguar forcë punëtore të fragmentuar, infrastrukturën dhe bazat e mëdha të të dhënave nga ish-sistemi. Fatkeqësisht, ato gjithashtu trashëguan mendësinë se ishin mbi ligjin dhe neverinë ndaj shoshitjes nga jashtë. Disa nga republikat e reja ishin më pak të suksesshme se të tjerat në braktisjen e këtyre trashëgimive.

Humori duhet të ketë qenë i zyrtë, nëse jo i pabindur, brenda radhëve të inteligjencës me mendësi elitare të shërbimeve sekrete. ‘Garda e vjetër’ kishte interes të drejtpërdrejtë në ruajtjen e një status

1 Shih Craig S. Smith, “Eastern Europe Struggles to Purge Security Services,” The New York Times, 12 dhjetor 2006.

2 “Spy scandals in eastern Europe reveal some damaging hang-ups,” The Economist, 19 dhjetor 2006.

quo-je të kultivuar me përfitim. Ajo e konsideronte veten si klub ekskluziv 'vetëm për anëtarët' dhe kishte kundërshtuar me sukses ndërhyrjet në botën e saj të sekreteve. Këta jo vetëm që ngurrnin t'ia nënshtronin kontrollit kompetencat e tyre, por edhe ballafaqimi me përgjegjësinë për veprimet e tyre ishte një mendim i pakëndshëm. Unë vetëm mund të imagjinoj se si nocioni i shoshitjes së jashtme dhe të pavarur nga organet parlamentare, gjyqësore ose organe të tjera duhet të ketë qenë veçanërisht vështirë të kapërdihet.

Vitet pasuese të integritimit Euro-Atlantik i hapën udhë një epokë të re. Shumë shërbime të sigurisë ndryshuan thellësisht. Një brez i ri i punonjësve operativë dhe i analistëve zëvendësuan forcën punëtore të Luftës së Ftohtë. Atyre do t'u jepej një mundësi të paparë për të punuar ngushtë me partnerët dhe aleatët e tyre të rinj perëndimorë. Interesat dhe vlerat e përbashkëta brenda BE-së dhe NATO-s, si dhe natyra transnacionale në rritje e sfidave të sigurisë siç është terrorizmi, hapën perspektiva të reja të rëndësishme për bashkëpunimin në sektorin e inteligjencës. Operacionet e përbashkëta të fshehta dhe ndarja e inteligjencës u bënë norma e re. Kjo gjithashtu hapi mundësi arsimimi dhe trajnimi për kuadrot e reja të profesionistëve të inteligjencës.

Megjithatë, organizatat e inteligjencës mbetën të rënduara nga trashëgimia e tyre shqetësuese, ndërlikimet e vetvetishme (fshehtësia), dhe cenueshmëritë e brishta ndaj abuzimeve me pushtetin dhe shkeljet e të drejtave të njeriut.

Peshimi i trashëgimisë dhe ambicieve

"Brenja ime kryesore është se ai nuk ka ndonjë përvojë operative ose të lidhur me inteligjencën," u ankua një deputet me përvojë nga nivelet e larta te një gazetar pas një seance dëgjimi me dyer të mbyllura në tetor 2012 në Komisionin e Politikës së Brendshme dhe të Sigurisë Kombëtare të Parlamentit Kroat. Komisioni sapo kishte votuar unanimisht për të mbështetur nominimin tim për drejtor të Agjencisë së Sigurisë dhe Inteligjencës (SOA) të Kroacisë. Ishte e paraparë me ligj që komisioni ndërpartiak me trembëdhjetë anëtarë, i kryesuar nga një deputet me përvojë nga nivelet e larta i partisë kryesore të opozitës, të jepte mendim paraprak për një kandidat përpara emërimit zyrtar nga Presidenti dhe Kryeministri. Ndërsa mendimi është jo-detyrues, ai ofron mundësinë që anëtarët e parlamentit (deputetët) të adresojnë shqetësimet, të ngrenë pyetje dhe të vlerësojnë nominimet e ekzekutivit.³

Seanca dëgjimore zgjati disa orë sfilatë, ndërsa deputetët shtruan një gamë të gjerë pyetjesh profesionale dhe personale. Cilat janë sfidat tona më të rëndësishme të sigurisë kombëtare? A mundeni dhe si do ta përmirësonit agjencinë? A besoni se ishte ide e mirë bashkimi shërbimeve të inteligjencës së jashtme dhe të shërbimeve të sigurisë së brendshme në një agjenci të vetme (SOA)? Pse mendoni se jeni personi më i kualifikuar për të drejtuar agjencinë? Çka mund të bëni për të promovuar barazinë gjinore në agjenci? Këto ishin vetëm disa nga shumë pyetjet që m'i bënë.

Unë u bëra drejtor i SOA pasi kalova nga Ministria e Mbrojtjes, ku kisha qenë Ndihmës Ministër për Çështje të Politikave dhe tashmë i kisha kushtuar mbi dy dekada të jetës sime shërbimit publik. Në veçanti, unë kisha përvojë të gjerë me bashkëpunimin ndërkombëtar dhe ndërinstucional, duke përfshirë punën në reformat e sigurisë dhe mbrojtjes, çështjet e lidhura me NATO-n dhe negociatat e BE-së dhe formulimin e strategjive, politikave dhe legjislativës të sigurisë kombëtare. Unë kisha bindje apolitike dhe nuk kisha asnjë lidhje me partitë politike. Marrja e përgjegjësisë së drejtimit të shërbimit civil të inteligjencës sonë kombëtare ishte gjithçka pos vendim i lehtë personal.

Udhëheqja e lartë e Agjencisë më informoi për aktivitetet tona të së kaluarës dhe ato të tanishme. Kisha ndjenja të përziera qysh herët. Isha i impresionuar dhe megjithatë disi ambivalent. Me sa dukej ne po grumbullonim informacionet e nevojshme dhe po i analizonim ato në mënyrë adekuate. Dhe në kohën e duhur, ne u ofronim produktet e përfunduara të punës autoriteteve të duhura, duke shpresuar se ata do të merrnin vendime të mirinformuara dhe do të merrnin masat e duhura për të mbrojtur interesat tona kombëtare. Tekefundit, mendoja, për këtë edhe bëhej fjalë në këtë punë.

3 Ndërsa rregulloret përvijojnë procedurat për emërimet dhe shkarkimet, nuk ka kërkesa ose kualifikime të caktuara që një i nominuar duhet t'i plotësojë në mënyrë që të emërohet drejtor i SOA. Qasjet kombëtare janë të ndryshme dhe shpesh varen nga një sërë faktorësh.

‘Sekretet familjare’

Nuk vonoi shumë dhe unë fillova të çmoj ndërlikimet e vërteta të punës sime, duke përfshirë edhe ‘sekretet tona familjare’, mungesat sistematike prapa fasadës dhe shumë sfida të tjera të cilat ende ishin para nesh.

Evolucioni i komunitetit të inteligjencës natyrshëm i pasqyroj shumë nga vështirësitë, sfidat dhe arritjet vetjake të Kroacisë. Trashëgimia e saj jugosllave, lufta e pavarësisë dhe aspiratat Euro-Atlantike të gjitha luajnë rol në formësimin se sa larg kemi shkuar dhe ku jemi sot. Gjatë rrugës, Kroacia adoptoi parimet e qeverisjes së mirë të menaxhimit të inteligjencës, të ndara nga shumë bashkëkohës të saj perëndimorë. Fakti që këto standarde të adoptuara perëndimore, të mbështetura me masa të gjera të mbikëqyrjes, mbetën të padiskutueshme dhe kurrë nuk u vënë në dyshim me seriozitet, ilustron vendosmërinë e Kroacisë për t’u bashkuar në radhët e klubit të mendësisë së njëjtë ndër demokracitë e NATO-s dhe BE-së.

Pjesa më e madhe e punës bazë për të sjellë strukturat e inteligjencës së Kroacisë në formën e homologëve të saj perëndimorë dhe për të rrënjësuar parimet demokratike të mbikëqyrjes, kontrollit dhe llogaridhënies, si dhe për krijimin e një fortifikimi me masa mbrojtëse kundër abuzimit të pushtetit, ishin vendosur shumë kohë para se unë të vija në Agjenci. Ndërsa këto parime ishin në fakt kufizime, respektimi i tyre ofroi shansin tonë më të mirë për të fituar besimin dhe mirëbesimin e publikut. Ato janë gjithashtu baza e legjitimitetit, integritetit dhe besueshmërisë sonë në kohë të vështira, duke shërbyer për të dekurajuar keqpërdorimin ose abuzimin e pushtetit nga autoritetet politike. Fatkeqësisht, edhe demokracitë më të shquara nuk janë imune ndaj abuzimeve. Me kalimin e viteve, shumë raste të paparashikuara do të vinin në provë kapacitetet tona.

Rast studimi: ‘Sekretet familjare’ - Pretendimet për punësim të paligjshëm

Në shkurt 2014, dolën raportime në media në lidhje me praktikën e parregullta të punësimit të SOA midis 2006 dhe 2008. Komisioni i mbikëqyrjes parlamentare shpalli një para-hetim zyrtar dhe krijoi një grup pune prej shtatë nga trembëdhjetë anëtarët e tij të përhershëm (katër deputetë nga koalicioni qeverisës dhe tre nga partitë e opozitës). Me kërkesën e tyre, deputetët morën një raport të detajuar të klasifikuar nga SOA. Ata gjithashtu u informuan në parlament nga drejtori i SOA dhe stafi i tij mbi historikun, metodologjinë, kriteret dhe rregulloret e rekrutimit të SOA. Deputetët gjithashtu vizituan selinë e SOA, me qasje të plotë për këqyrje të të gjitha dokumenteve në lidhje me çështjen. Nga fundi i majit, komisioni adoptoi konkluzione që ishin kritike ndaj praktikave të mëparshme të punësimit dhe të emërimeve. Deputetët e partisë kryesore opozitare nxorën një mendim të veçantë mospajtues. Të dy këto rrodhën në media. Çështja u shqyrtua gjithashtu nga Zyra e Këshillit të Sigurisë Kombëtare dhe u hetua nga prokurori i shtetit. Asnjë akuzë nuk u ngrit asnjëherë dhe askush nuk u thirr për llogaridhënie. Këshilli i Sigurisë Kombëtare u takua në 4 korrik dhe doli me deklaratë publike që pretendonte se kishte pasur keqbërje, por megjithatë shmangte akuzat e drejtpërdrejta për sjellje të paligjshme. Deklarata përshkroi gjithashtu praktikën e parregullta të punësimit të SOA si “të papranueshme” dhe “risk për sigurinë”, që minojnë “reputacionin dhe besueshmërinë” e SOA. Deklarata përfundoi më tej se rregulloret dhe masat zyrtare të adoptuara kohët e fundit do të parandalonin dukuritë e ngjashme në të ardhmen.


Korniza e re ligjore

Themelet aktuale të sistemit të inteligjencës së sigurisë së Kroacisë u ravijëzuan dhe u përkufizuan me një ligj gjithëpërfshirës dhe unifikues në 2006.⁴ Ky ishte kulmi i shumë viteve të transformimit pas konfliktit dhe hapi përfundimtar lidhur me inteligjencën drejt anëtarësimit Euro-Atlantik. Nga aspekti meritor, ligji është gjithëpërfshirës dhe megjithatë konciz. Ai padyshim që shënoi fillimin e një epoke të re për sa i përket komunitetit të inteligjencës në Kroaci. Grupet e shoqërisë civile, disa ekspertë akademikë dhe partitë opozitare kishin ca mëdyshje, duke theksuar miratimin e pakontrolluar të disa masave speciale (vëzhgimi) dhe mangësitë e mbikëqyrjes. Nga aspekti praktik, dhe përkundër disa skandaleve shqetësuese, është e jashtëzakonshme se sa mirë ky ligj i ka bërë ballë kohës.

4 Ligji për Sistemin e Sigurisë dhe Inteligjencës të Republikës së Kroacisë, i adoptuar në 2006, paraqiti një sërë ndryshimesh sistematike.

Ligji përcaktoi bashkimin e Agjencisë së Inteligjencës (së jashtme) dhe Agjencisë së Kundërzbulimit. SOA u shfaq si një shërbim i vetëm civil përgjegjës për sigurinë e jashtme dhe të brendshme, me zyra rajonale në të gjithë vendin. Ligji gjithashtu themeloi një agjenci të inteligjencës ushtarake (VSOA) dhe një Qendër Operative Teknike (OTC), kjo e fundit një organ i pavarur që administron përgjimin e telekomunikimeve.⁵ Duke futur një kontroll të efektshëm ekzekutiv përmes Këshillit të Sigurisë Kombëtare dhe strukturave të shumta me mbikëqyrje të gjerë, u iniciua puna bazë për promovimin e sundimit të ligjit, llogaridhënies dhe parimeve themelore demokratike. Këta mekanizma të rinj do të testoheshin shpesh. Anëtarësimi i SOA në vitin 2015 në Club de Berne - forumi diskret i ndarjes së inteligjencës në Evropë - dhe bashkëpunimi i saj i fuqishëm ndërkombëtar me demokracitë kryesore në botë u përdor si dëshmi e arritjeve të saj të përgjithshme.

Sistemi i Inteligjencës së Sigurisë në Kroacië



Një betejë e rëndë: ndërtimi i besimit të publikut

Sidoqoftë, agjencia nuk ka qenë imune ndaj akuzave për abuzim të pushtetit, fshehje të shkeljeve apo shkelje të të drejtave, duke çuar shpesh në kritika dhe dyshime të hapura nga publiku. Përveç disa rasteve të profilit të lartë, pretendimet për keqëbërje rrallë kishin marrë përfundimin e duhur. Efektiviteti i mbikëqyrjes parlamentare ishte tepër i varur nga animet partiake. Informacioni i klasifikuar shpesh rridhte për qëllime politike vetë-shërbyese ose me qëllim të diskreditimit publik të kundërshtarëve. Në dy skandale të ndara, që morën shumë publicitet gjatë mandatit tim, komisioni parlamentar i mbikëqyrjes që hetoi akuzat për sjellje të keqe u nda përgjatë vijave partiake. Në të dy rastet (e ilustruara), perceptimet se konkluzionet e komisionit do të dëmtonin partitë e tyre përkatëse politike mbizotëruan detyrimin e deputetëve për të vepruar si arbitra të paanshëm. Politika partiake doli mbi detyrën, integritetin dhe standardet më të larta morale. Nuk është çudi që ne kurrë nuk morëm guximin për të matur haptas opinionin popullor. Ndërtimi i besimit të publikut do të bëhej një aspiratë personale, një aspiratë që në shpresojta do të përqafohej nga të gjithë drejtorët.

Vëmendja ime, sikur në mënyrë të paracaktuar, u zhvendos drejt 'aspekteve bazike praktike' të punës sonë kryesore të mbledhjes, analizimit dhe shpërndarjes së inteligjencës. Në të njëjtën kohë, po mendoja se ishte po aq e rëndësishme të siguroja që i kishim harmonizuar mirë funksionet e rregullta të mbështetjes. Nënvlërësimi i rëndësisë së tyre në një organizatë të mbizotëruar nga punonjësit operativë dhe analistët ishte një kurth në të cilin nuk do t'ia lejoja vetes të futem. Të gjitha pjesët e organizatës duhet të përshataten mirë së bashku.

⁵ Agjencia e Sigurisë dhe e Inteligjencës Ushtarake (VSOA), agjenci simotër e SOA brenda Ministrisë së Mbrojtjes, ishte përgjegjëse për kërcënimet ushtarake dhe të mbrojtjes ndaj sigurisë kombëtare të Kroacisë. OTC është shkurtesë për Qendrën Operative-Teknike për Mbikëqyrjen e Telekomunikimeve. Për një pasqyrë të plotë të sistemit të inteligjencës në Kroaci, shih <https://www.soa.hr/en/about-us/security-intelligence-system-of-the-republic-of-croatia/>.

⁶ Ligji ravijëzoi tri struktura të pavarura, por disi të lidhura jo-ngushtë, të mbikëqyrjes: parlamentare (komisioni parlamentar), administrative (ekspertët) dhe civile (sektori jo-qeveritar).

Fillimi i reformave

Matja e efektivitetit tonë nuk do të ishte punë e lehtë. Njohësit e Agjencisë ngritën argumentin se suksesi ynë matet me 'gjëra që nuk ndodhin' dhe jo me 'gjëra që ndodhin'. Për shembull, pos në rast të një sulmi të drejtpërdrejtë terrorist, ne do të duhej të hamendësojmë se përpjekjet tona kundër terrorizmit po funksiononin. Mbajtja e SOA larg faqes së parë të gazetës ishte në krye të nivelit të ambicies sonë. Por, nuk duhet shumë urtësi për të kuptuar se kjo linjë arsyetimi mund të ketë të meta. Pra, nuk ishte e dukshme nëse ne, në fakt, bënim mirë punën tonë, ishim thjesht fatlumë, apo ishim diku nga mesi.

Bota përreth nesh ishte në gjendje fluksi. Një sërë faktorësh të ndryshëm do të ndikonin në punën tonë. Jo vetëm që po ndryshonte me shpejtësi mjedisi ynë i kërcënimeve, por krahas përparimeve në teknologji, ndryshimeve të kërkesave të brendshme, presionit të konkurrencës dhe rritjes së ndër-varësive ndërkombëtare, ne po përjetonim 'dhimbjet tona të rritjes' si një agjenci. Na duhej t'i shtronim vetes shumë pyetje. A po ndryshon roli ynë? A ishin akoma të dobishme parimet dhe qasjet tradicionale të inteligjencës? Çfarë lloj njohurie dhe cilat aftësi do të na duheshin në të ardhmen? Si ndikon teknologjia e re në punën tonë? Çfarë lloj njerëzish do të duhej të punësojmë dhe si do të duhej t'i trajnojmë ata?

Baza kryesore e përpjekjeve të inteligjencës, aftësia konvencionale për të marrë informacione, dukej se po zhvendosej në favor të një kapaciteti për të menaxhuar, sistemuar dhe kuptuar sasi të mëdha informacioni

dhe të dhënash, shpesh të gatshme dhe në dispozicion për një gamë të gjerë aktorësh të tjerë gjithashtu. Rreziqet dhe kërcënimet e sigurisë po ndryshonin, duke e bërë gjithnjë e më të vështirë adresimin e tyre nga ne vetë. Kështu, aleancat dhe partneritetet u bënë asete të rëndësishme dhe shumëzuesit kryesorë të pushtetit. Terrorizmi dhe sfidat tjera transnacionale e përshpejtuan bashkëpunimin ndërkombëtar në nivele të papara. Në Kroaci, pritjet qeveritare dhe qëndrimet e publikut po ndryshonin. Kjo e bëri të nevojshëm një rivlerësim themelor të praktikave të SOA.

Vetë-vlerësimi i agjencisë

Gjatë vitit tim të parë në detyrë, ne krijuam një grup punues të ekspertëve të SOA, i ngarkuar me detyrën për të vlerësuar sfidat dhe mangësitë tona. Ishte një vlerësim brenda shërbimit ose vetë-vlerësim i Agjencisë. Pas disa muajsh, grupi përgatiti një raport të gjerë të gjetjeve të tyre së bashku me një grup të rëndësishëm rekomandimesh të gjera. Ndërsa gjetjet nxitën diskutime të nxehta brenda udhëheqjes së lartë të Agjencisë, ishte e vështirë të shpërfillen përfundimet e grupit punues. Raporti do të bëhej më vonë baza për planin tonë strategjik të zhvillimit.⁷

Roli i SOA mbeti kryesisht i pandryshuar, megjithëse ne e pranuan nevojën për vigjilencë dhe fleksibilitet kur kemi të bëjmë me pasiguritë e ardhshme. Ne do të vazhdonim me ofrimin e një shërbimi të rëndësishëm në mbrojtjen e sigurisë kombëtare të Kroacisë. Megjithatë, ne gjithashtu po luftonim për të hequr barrën e një kulture të rrënjosur në sektorin e inteligjencës të 'punës sipas mënyrave të vjetra'. Kishte nevojë të ngushtonim përpjekjet tona dhe të bëheshim më të përqendruar te misioni dhe të orientuar drejt synimit. Po kështu, ne dëshironim të zhvendosim ekuilibrin në favor të më shumë investimeve në të ardhmen tonë, për dallim nga preferenca jonë e lindur për t'u marrë me ngjarjet aktuale ose 'problemin e ditës'. Në fakt, ne kishim nevojë t'i trajtonim përpjekjet tona të inteligjencës sikur të kishim të bëjmë me një 'ndërmarrje'.

Identifikimi i kërkesave dhe prioriteteve të inteligjencës

Transformimi ynë do të kërkonte theks më të madh në të menduarit strategjik dhe të ngjashëm me korporatat, në mënyrë që të përcaktojmë se si mund ta përmbushim misionin tonë. Në bashkëpunim të ngushtë me klientët tanë - presidentin, qeverinë dhe institucionet shtetërore që veprojnë në bazë të produkteve tona ose përfitojnë nga veprimet tona - imperativi i parë ishte vendosja e kërkesave dhe prioriteteve të qarta të inteligjencës. Në vitet e mëparshme, direktivat tona vjetore të politikave ishin të paqarta, jashtëzakonisht të gjera dhe shpesh kopjoheshin nga vitet e mëparshme. Ne gjithashtu duhej të krijonim një mjet për të matur kënaqshmërinë e klientit. A po i plotësonim nevojat e tyre të inteligjencës dhe a po i përmbushnim pritjet e tyre?

⁷ Fatkeqësisht, të dy dokumentet janë me klasifikim të lartë dhe nuk janë në dispozicion të publikut. Sfidat e gjenerimit të një vlerësimi objektiv të performancës së një agjencie është shumë e kufizuar nga velloja e saj e hekurt e fshehtësisë dhe dyert e mbyllura për të personat e jashtëm.

Investimi në zhvillimin e aftësive të reja

Si me çdo organizatë, menaxhimi i resurseve dhe pasurive tona ishte kritik. Resurset tona më të vlefshme ishin, dhe do të vazhdojnë të jenë, njerëzit tanë (ju kërkoj falje për klishe). Madje edhe kur ne adoptojmë teknologjinë e re, njerëzit tanë do të jenë ata që do të duhet ta përdorin atë. Rekrutimi, punësimi dhe menaxhimi i karrierës në institucionin tonë kishin nevojë për një rindërtim të plotë.⁸ Më parë, theks i vogël sistematik ishte vendosur te trajnimi dhe ne nuk i kishim kushtuar shumë vëmendje zhvillimit të udhëheqësve të ardhshëm. Buxheti ynë ishte i tendosur nga alokimet e pagave dhe kostot e larta të mirëmbajtjes. Kjo linte pak hapësirë për të investuar në aftësi të reja dhe gjasat ishin shumë të vogla që buxheti ynë të rritet. Na duhej të 'shtrëngonim rripin' dhe të bënim përpjekje serioze për të rirreshtuar shpenzimet tona financiare. Dhe ne e bëmë mu këtë. Në më pak se dy vjet, ne ulëm kostot e personelit me dhjetë për qind dhe rritëm investimet për më shumë se dyfish. Pa ngritur nivelin e ambicies sonë, gjegjësisht një prag më të lartë për investimet vjetore në modernizim dhe zhvillim, ne mund të rrezikojmë aftësinë tonë për të përmbushur misionin tonë në të ardhmen.⁹

Rruga drejt paradigmave të reja

Ne gjithashtu ndiem se ishte koha për të sfiduar paradigmën e vjetër të rrënjësor të fshehtësisë dhe për të bërë hapjen graduale për publikun. Tekefundit, roli ynë, siç përcaktohet nga ligji, nuk ishte vetëm për të mbrojtur interesat kombëtare (shpesh abstrakte) dhe rendin kushtetues, por ishte gjithashtu detyra jonë për të mbrojtur qytetarët tanë. Ata gjithashtu duhej t'i dinin përfitimet nga shërbimi që ne ofronim ose, të paktën, të informoheshin për atë që bëjmë, dhe për më tepër, për kërcënimet me të cilat përballëj kombi ynë. Sidoqoftë, jo të gjithë në komunitetin e inteligjencës së Kroacisë ranë dakord. "Do të mjaftonte," më tha një zyrtar i lartë, "që vetëm disa prej nesh në qeveri janë në dijeni për meritat e Agjencisë." Por perceptimet publike të ushqyera nga vite të tëra të mbulimit kritik të mediave më bindën për të kundërtën.

Fitimi i besimit dhe respektit të publikut përmes mbikëqyrjes efektive

Qëllimi ynë nuk ishte të fitonim respektin e shoqërisë nga frika, si në të kaluarën, por nga bindja në justifikimin dhe legjitimitetin e veprimeve tona, si dhe nga besueshmëria në kompetencën tonë. Besimi dhe mbështetja e fortë e publikut do të ndihmonte shumë në përmbushjen e misionit tonë. Por, ndryshe nga ministritë dhe institucionet e tjera të qeverisë, aftësia jonë për të shpjeguar veten ose për të mbrojtur veprimet tona është dukshëm e kufizuar. Ne duhej të mbështeteshim te të tjerët, veçanërisht tek ato institucione me përgjegjësi kontrolli dhe mbikëqyrjeje.

Isha plotësisht i vetëdijshëm se organet tona mbikëqyrëse tri-shtresore — një komision parlamentar i përherëshëm dhe dypartiak, Zyra e Këshillit të Sigurisë Kombëtare dhe Komisioni i Mbikëqyrjes Civile — kishin rol të rëndësishëm këtu. Me aftësi hetimore dhe mbikëqyrje thelbësisht të pakufizuar, ata ishin në pozicion të mirë për të shqyrtuar ankesat, për të vërtetuar faktet dhe për të verifikuar legjitimitetin e çdo aktiviteti të diskutueshëm. Pasi u aktivizuan, organet mbikëqyrëse u autorizuan të intervistojnë çdo pjesëtar të stafit të agjencisë dhe të shqyrtojnë të gjitha dokumentet e lidhura me çështjet.¹⁰ Ndërsa ato mund të kenë mbivendosje në hetimet e tyre, kapacitetet dhe autoritetet e tyre përkatëse të mbikëqyrjes dallojnë shumë, meqë secili organ teknikisht luan një rol unik. Komisioni parlamentar ka përparësi ligjore meqë neni 80 i Kushtetutës së Kroacisë posaçërisht ngarkon parlamentin me detyrën e ushtrimit të mbikëqyrjes së "shërbimeve të sigurisë".

Komisioni parlamentar mund t'ia bartë mbikëqyrjen njërit prej dy organeve të tjera. Në atë kuptim, Zyra e Këshillit të Sigurisë Kombëtare ka ekspertizën dhe njohuritë për të parë çështjet në mënyrë të pavarur ose në mbështetje të një hetimi parlamentar. Kjo zyrë ka staf me përvojë dhe kryen inspektime vjetore të planifikuara të mbikëqyrjes, për të cilat i raportojnë presidentit dhe kryeministrit. Kjo u mundëson atyre që të çmojnë në mënyrë të veçantë dhe të kenë kuptim të plotë të mënyrës se si funksionon SOA. Po kështu, komisioni civil është një mekanizëm unik mbikëqyrës që nuk gjendet në shumë demokraci. Komisioni është përgjegjës para parlamentit dhe përbëhet nga shtatë individë të emëruar për një mandat

8 Në vitin 2014 shpërtheu një skandal i madh kur një sinjalizues zbuloi informacion të klasifikuar në media që tregonte për parregullsitë e mëparshme të punësimit në SOA. Kjo përfundimisht çoi në një hetim nga komisioni parlamentar, përfundimi i të cilit tregoi se kishte ndarje përgjatë vijave politike midis koalicionit qeverisës dhe deputetëve të opozitës.


9 Siç tregojnë dokumentet e saj të fundit publike, SOA që nga ajo kohë ka vazhduar të rritë investimet e saj në modernizimin dhe zhvillimin e aftësive.

10 Sipas Nenit 105, Seksionit 3, të Ligjit për Sistemin e Sigurisë dhe Inteligjencës të Republikës së Kroacisë, e drejta për të parë informacionet lidhur me çështjet e klasifikuara nuk përfshin qasjen në identitetin e burimeve të SOA ose informacionin e inteligjencës të ofruar nga shërbimet e huaja pa pëlqimin e tyre.

katër-vjeçar. Vlera e tyre qëndron në kapacitetin e tyre autoritar për të hetuar pretendimet individuale të abuzimit, duke lejuar komisionin parlamentar të përqendrohet në çështjet më të rënda.

Sigurisht, praktikisht e gjithë kjo zhvillohet pas dyerve të mbyllura në mënyrë që të mbrohet informacioni i klasifikuar i SOA, si dhe agjentët, burimet dhe mënyra e operimit të saj klandestin.

Mbikëqyrja e sektorit të inteligjencës



Akuzat për sjellje të pavend, qoftë nga Agjencia apo zyrtarët individualë, duhej të hetoheshin hollësisht dhe menjëherë.¹¹ Ndërsa organet e mbikëqyrjes mund të veprojnë në mënyrë të pavarur, niveli ekzekutiv (presidenti dhe kryeministri) gjithashtu mund të kërkojnë nga Zyra e Këshillit të Sigurisë Kombëtare të shqyrtojë një incident, dhe ka përgjegjësinë kryesore për të kërkuar llogari nga SOA. Nuk mbaron këtu. Përfundimet e një hetimi dhe çdo masë pasuese duhet të komunikohen me vend për publikun në mënyrë që të ruhet ose të rivendoset besimi.

Ky ishte tashmë një model i mirëvendosur, i zakonshëm në demokracitë perëndimore. Në praktikë, për fat të keq, nuk funksionon gjithmonë siç pritet. Politikat partiake dhe interesat vetjakë mund të pengojnë lehtësisht procesin, ashtu si edhe mungesa e vullnetit ose vendosmërisë politike. Dhe demokracitë më të shquara të botës ende nuk kanë zbuluar një ilaç për papjekurinë, delikucencën ose marrëzinë politike. Në demokracitë liberale, agjencitë e inteligjencës janë të pafuqishme meqë zyrtarët e zgjedhur në mënyrë legjitime dhe me të drejtë mbajnë përgjegjësinë për drejtimin e mbikëqyrjes. Sidoqoftë, ato luajnë një rol vendimtar të 'rojës kombëtare' që kërkon llogari nga SOA, duke ndikuar drejtpërdrejt në besimin e publikut që ne po synojmë të arrinim.

Nuk kisha iluzione për sfidat përpara nesh.

Hartimi i një kursi të ri të modernizimit dhe transformimit

Në thelb, në fund kishim të bëjmë me një zgjedhje të thjeshtë: të rrezikojmë të biem pre e rrethanave në ndryshim ose të përshtatemi dhe të orvatemi të drejtojmë shërbimin në kursin e dëshiruar të modernizimit dhe transformimit me shikim kah e ardhmja. Ky nuk ishte një vendim i vështirë meqë unë isha zotuar fuqimisht për ta lënë agjencinë një institucion më të mirë, më të aftë dhe më llogaridhënës në fund të mandatit tim katër-vjeçar si drejtor.

¹¹ Në vitin 2019, meqë nuk ishte rregulluar në mënyrë adekuate në të kaluarën, Kroacia adoptoi një ligj të ri për 'mbrojtjen e sinjalizuesve', për mbrojtjen e individëve që raportojnë keqëri në lidhje me punën. Shih https://www.cms-lawnow.com/ealerts/2019/11/experts-welcome-croatias-new-whistleblower-act-but-warn-of-flaws?cc_lang=en.

A Strategic Development Context

Isha i vendosur që si pikënisje të prezantoja një arsyeshmëri strategjike dhe të shfrytëzoja potencialin e kombit tonë. Duke vepruar kështu, ne u këshilluam me udhëheqësit kryesorë të korporatave dhe ekspertët e teknologjisë të Kroacisë. Ne krijuam partneritete formale me institucionet kryesore akademike dhe kërkimore. Ne gjithashtu kërkuam mbështetje nga partnerët kryesorë ndërkombëtarë. Përfundimisht, ne identifikuam tri objektiva strategjike.

Ndikimi strategjik

Së pari, ne donim që përpjekjet tona të kishin një ndikim strategjik. Puna e inteligjencës do të duhej të ketë një efekt të palëkundur në politikën e sigurisë. Kjo do të duhej të çojë në veprime të drejtpërdrejta nga institucionet tjera ose të paraqesë një bazë për marrjen e vendimeve të rëndësishme qeveritare. Ne do të duhej të mbledhim informacione të veprueshme. Por që të ndodhë kjo, duhet të ketë ndërveprim të qëndrueshëm ndërmjet zyrtarëve të inteligjencës dhe politikëbërësve. Kërkesat e inteligjencës duhet të përcaktohen me prioritet, të jenë të qarta dhe të rivlerësohen rregullisht. Ne nuk kemi hesap të harxhojmë resurse në përpjekje që rezultojnë në një produkt të shpërndarë gjerësisht, por rrallë të dobishëm. Ne do të duhej të përqendrohemi në çështjet e rëndësishme dhe të shfrytëzojmë avantazhin tonë krahasues.

Kohezioni i brendshëm dhe aspirata për përsosmëri

Së dyti, ne donim të maksimizojmë kohezionin e brendshëm dhe të institucionalizojmë një aspiratë të përhershme për përsosmëri. Mjedisi i përkohshëm i sigurisë dhe zhvillimi tejte i shpejtë i teknologjisë kërkojnë një organizatë që inkurajon novacionin dhe kreativitetin. Shtabet qendrore, qendrat rajonale dhe operativët tanë duhet ta kenë të përbashkët një fokus të qartë të misionit dhe duhet të veprojnë njëtrajtshëm. Ne duhet të jemi në gjendje të transferojmë njohuri nga një brez në tjetrin, ndërsa zhvillojmë aftësi të reja që agjentëve tanë do t'u duhen në të ardhmen. Kjo është veçanërisht e vërtetë për shërbimet me resurse dhe aftësi modeste. Kjo nënkupton një theks më të madh në arsim dhe trajnim, si dhe krijimin e përpjekjeve të përqendruara në mision dhe ekipeve fleksibël të detyrave të veçanta.

Partneritetet e forta ndërkombëtare

Së treti, na duhej të ndërtonim partneritete të forta ndërkombëtare. Duke pasur parasysh natyrën transnacionale të shumicës së kërcënimeve, është e vështirë të imagjinohet ndonjë shërbim që mund t'i plotësojë kërkesat e sigurisë kombëtare pa ndihmën e askujt. Bashkëpunimi i inteligjencës nuk është më një opsion; është një domosdoshmëri. Vetë ndërlidhja e shoqërive tona kërkon një shërbim modern që ka rrjet të marrëdhënieve ndërkombëtare. Ndërtimi i besimit dhe besueshmërisë është përbërës kryesor për bashkëpunim efektiv. Disa forume shumëpalëshe dhe rajonale ofrojnë korniza për bashkëpunim në mbarë Evropën.¹² Bashkëpunimi mund të jetë gjithashtu efektiv në nivelin dypalësh ose në përpjekjet ku përfshihen vetëm disa shërbime. Jo vetëm që është e domosdoshme të vendosen lidhje institucionale të qëndrueshme, por, për shkak se zyrtarët e sigurisë dhe inteligjencës janë profesionistë të karrierës, është veçanërisht e rëndësishme të krijohen gjithashtu marrëdhënie personale.

Këto objektiva janë të ndërlidhura dhe mbështeten në mënyrë të ndërsjellë. Ato përkufizuan bazën e planit tonë strategjik të zhvillimit, që iu paraqit para presidentit dhe qeverisë në vitin tim të parë si drejtor. Plani u adoptua gjithashtu me votë unanime ndër-partiake në komisionin parlamentar të inteligjencës të Kroacisë. Kjo ka qenë me rëndësi kyçe në shtyrjen përpara të shumë përpjekjeve, iniciativave dhe projekteve të ndërmarra që prej asaj kohe. Për fat të mirë, plani kërkonte fare pak ndryshime në strukturën tonë organizative, të cilat do t'i nënshtroheshin aprovimit të jashtëm (ekzekutiv).

Decentralizimi i autoritetit

Një nga qëllimet e mia të deklaruara ishte decentralizimi i autoritetit, përkufizimi më i qartë i përgjegjësisë dhe krijimi i një marrëdhënieje më të ekuilibruar ndërmjet ndërmjetësve kryesorë të pushtetit në Agjenci. SOA ishte shumë e centralizuar, me operacione dhe me një drejtor të gjithëfuqishëm që kishte promovuar kulturën organizative të dominimit. Mënyra për ta ndryshuar këtë ishte duke deleguar


¹² Pasardhësi im arriti të mblidhte përfaqësuesit e 23 subjekteve brenda komunitetit evropian të inteligjencës në Zagreb, më 26 shkurt 2020, për të nënshkruar një letër qëllimi për krijimin e "Kolegjit të Inteligjencës të Evropës", një forum për bashkëpunim rreth trajnimit, edukimit dhe shkëmbimit të njohurive në fushën e inteligjencës. Megjithatë iniciativë franceze, SOA ka luajtur rol aktiv dhe do të kryesojë këtë iniciativë në vitin e parë të krijimit të saj.

autoritetin dhe duke promovuar një qasje në nivel të 'tërë agjencisë' për të përmbushur misionin tonë. Kjo nënkuptonte vizibilitet më të madh për ekspertët teknikë dhe stafin mbështetës. U krijua një bord i nivelit të lartë drejtues për të diskutuar opsionet dhe prioritetet, si dhe për të përgatitur propozimet për adoptim formal. Shumica e përpjekjeve tona ranë në tri kategori të përgjithshme:

- aftësitë e mbledhjes, operacioneve dhe analizës;
- teknologjia dhe modernizimi; dhe
- proceset e organizimit, menaxhimit dhe biznesit.

Iniciativat e reja shkonin nga institucionalizimi i mësimëve operacionale të mësuara dhe zhvillimi i aftësive moderne të HUMINT deri te krijimi i një skeme të re punësimi dhe një sistemi të automatizuar të menaxhimit dhe planifikimit të karrierës. Për më tepër, u filluan disa projekte të rëndësishme teknologjike, në mënyrë që të na bënin të mundur të zinim hapin me trendet globale. Fatkeqësisht, disa iniciativa duheshin braktisur. Ne vlerësuam arritjet tona vjetore dhe qoftë modifikuam prioritetet individuale ose adoptuam prioritetet e reja. Por, mbase arritja jonë më e shquar ishte udhëheqja dhe puna ekipore në mbarë agjencinë prapa secilës prej këtyre përpjekjeve. Ky mund të jetë faktori kritik që garanton qëndrueshmërinë dhe zhvillimin e SOA në të ardhmen.

Struktura Organizative e SOA



Unë isha i bindur se ne kishim vënë në lëvizje një proces që do të formonte përpjekjet tona të inteligjencës në një ndërmarrje shumë efektive të shërbimit publik. Ndërsa kjo qasje pothuajse si në biznes kishte kufizimet e saj, ishte padiskutueshëm e dobishme për të larguar ndjenjën e vetëkënaqësisë dhe për të ndezur dëshirën për të bërë më shumë, për të performuar më mirë dhe për të arritur lartësi të reja. Palët tona të interesit nuk do të duhej të pranojnë asgjë më pak sepse mbrojtja e interesave tona jetike dhe siguria jonë kombëtare varej nga kjo.

Trendet, mundësitë dhe sfidat

Ekspertiza që i ofrohet politikëbërësve nga agjencitë e inteligjencës ekziston brenda një arene të re, tejet konkurruese dhe duhet të pranojmë që ne nuk kemi më monopol intelektual mbi inteligjencën. Ekziston një përhapje e analizave të gatshme nga burimet e hapura që janë të disponueshme dhe të prodhuara nga një larmi aktorësh, duke përfshirë kompani private, ente studimore (think tank), universitete, shtëpi mediale dhe ekspertë individualë të fuqizuar nga interneti. Konkurrentët tregtarë, përfshirë ata që punësojnë ish-ekspertë të inteligjencës, po shfaqen me shpejtësi të madhe dhe po ofrojnë shërbimet e tyre në tregun e hapur. Për më tepër, udhëheqësit tanë politikë dhe politikëbërësit janë më të informuar se kurrë më parë dhe shpesh kanë burimet e veta, zakonisht të mirinformuara.

Nga mbledhja te vërtetimi i informacionit

Volia, besueshmëria dhe fleksibiliteti i mjeshtërisë së zanatit tonë do të testohen si kurrë më parë. Ne do të duhet të jemi shumë më mirë jo vetëm në mbledhjen e informacionit, por më e rëndësishmja, në dallimin,

sistemimin dhe analizimin e të dhënave. Dhe ne do të duhet ta bëjmë këtë më shpejt dhe t'i paraqesim përfundimet tona në një mënyrë më bindëse sesa ishte parashikuar më parë. Rritja e keqinformimit dhe dezinformimit i ndërlikon punët, meqë gjendemi në një të ashtuquajtur epokë të 'të vërtetave nga postimet'. Çka është lajm i vërtetë dhe çka është 'lajm i rremë' do të jetë gjithnjë e më e vështirë për t'u dalluar. Pra, në vend që të thirremi për të dhënë informacion, gjithnjë e më shumë mund të na kërkohet të japim qartësi, të vërtetojmë fakte ose thjesht të konfirmojmë besueshmërinë e tyre.

Menaxhimi i pritjeve

Palët e interesuara do të presin që shërbimet e inteligjencës të parashikojnë madje edhe rreziqet margjinale në periferinë e spektrit të kërcënimeve. Ato gjithashtu do të prezumojnë se ne kemi kompetenca mistike, nganjëherë supra-shtetërore për të parandaluar kërcënimet. Ndërsa thelbi i punës sonë është të ofrojmë paralajmërim të hershëm dhe vështrime të thella analitike mbi çështjet e sigurisë, pritjet me siguri do të shkojnë përtej realitetit. Pikë së pari, agjencitë e inteligjencës nuk kanë një top kristali për të parashikuar të ardhmen dhe sigurisht që nuk kanë përgjigje për të gjitha telashet e kombit tonë. Inteligjenca nuk mund të jetë zëvendësim për politikë-bërjen. Përkundrazi, agjencitë e inteligjencës i shërbejnë procesit të hartimit të politikave. Dobia e SOA qëndron në njohjen e asaj që nevojitet (kërkesat e inteligjencës) dhe mënyrës se si përdoret shërbimi që ajo ofron (vendimet e politikave). Kufizimet e inteligjencës nuk mund të përdoren si alibi për mosveprim dhe as si kompensim për institucionet e tjera që nuk bëjnë punën e tyre. Telashi i politikëbërësve, siç vuri në dukje Henry Kissinger shumë kohë më parë, është se vendimet shpesh duhet të merren shumë kohë përpara se të dihet mjaftueshëm për t'i justifikuar ato plotësisht.

Bashkëpunimi brenda platformave shumë-institucionale

Trajtimi efektiv i sfidave të ardhshme do të varet gjithnjë e më shumë nga kapaciteti dhe aftësia e SOA për të punuar brenda platformave vendore shumë-institucionale. SOA nuk ka kompetenca policore ose për zbatim të ligjit. Informacioni që mbledh, megjithëse është i dobishëm për policinë dhe prokurorët e shtetit, nuk mund të përdoret në procedime penale. Marrëdhënia e saj me organet e zbatimit të ligjit ka qenë e trazuar, ndonëse në skenarin më të mirë e tolerueshme. Ndërsa mbi-vendosja në rritje e përgjegjësisë shpesh çon në fërkime të lehta, ekziston një nevojë e fortë e ndërsjellë për të koordinuar dhe bashkëpunuar. SOA ka nënshkruar marrëveshje me organet e zbatimit të ligjit dhe disa partnerë të tjerë kryesorë kombëtarë. Pavarësisht nëse përballemi me kërcënim terrorist të brendshëm, veprimtari subversive, ekstremizëm, krime të nivelit të lartë dhe raste komplekse korrupsioni, sulme kibernetike ose veprimtari të tjera të paligjshme, aftësia jonë për të punuar së bashku është kritike për reagimin tonë efektiv si komb.

Pasojat e digjitalizimit dhe teknologjive të reja

Teknologjia ofron shërbime të sigurisë me një mori mundësish të reja, si në mbledhjen e inteligjencës ashtu edhe në analizën e saj. Ne jetojmë në një shoqëri gjithnjë e më të digjitalizuar që prodhon vëllime të mëdha të të dhënave, që më parë ishin të paimagjinueshme. Përparimet në fushën e inteligjencës artificiale mund të ndihmojnë në aspektet sfiduese të përpunimit. Por, kjo mund të shfrytëzohet edhe nga kundërshtarët tanë. Ndërsa enkriptimi mundëson komunikim të sigurt, ai gjithashtu e bën jashtëzakonisht të vështirë për agjencitë e sigurisë dhe të zbatimit të ligjit për të përgjuar komunikimet e terroristëve dhe kriminelëve të dyshuar.

Gjithashtu, publiku ka kërkesa në rritje me zhvendosje të vazhdueshme të theksit ndërmjet sigurisë dhe privatësisë. Njerëzit janë kuptohet skeptikë dhe rezistues ndaj kompetencave të fshehta dhe ndërhyrëse që i kanë në dispozicion agjencitë e inteligjencës. Ndërsa privatësia është e drejtë themelore, ajo mund të mbizotërohet në mënyrë të legjitime nga shqetësimet e sigurisë kombëtare dhe sigurisë publike. Sidoqoftë, masat e vendosura mbrojtëse dhe shkalla në të cilën agjencitë e inteligjencës dhe ato të zbatimit të ligjit mund të përdorin kompetencat e tyre ndërhyrëse të hetimit dhe vëzhgimit mund të ndryshojnë. Në shoqërinë tonë të digjitalizuar me rrjete të mbi-vendosura dhe të ndërlydhura, futja e novacioneve teknologjike në treg shpesh ndodh përpara se të përshtatet legjislacioni i brendshëm përkatës.

Rast studimi: Akuzat për vëzhgim të paligjshëm

Në majin e vonshëm të vitit 2014, një ish-ministër, i cili ishte hequr kohët e fundit nga qeveria e koalicionit në pushtet, akuzoi kryeministrin për abuzim të pushtetit, duke pretenduar se ai dhe familja e tij kishin qenë cak i vëzhgimit të paligjshëm nga shërbimet e sigurisë. Pasi urdhëroi Zyrën e Shërbimit të Sigurisë Kombëtare të hetojë menjëherë pretendimet, Presidenti thirri një konferencë për shtyp duke zbuluar gjetjet e tyre se SOA nuk ishte përfshirë në asnjë mënyrë. Brenda pak ditësh, komisioni parlamentar i mbikëqyrjes së inteligjencës njoftoi se kishte marrë një ankesë formale dhe do të niste para-hetimin zyrtar. Komisioni kërkoi raporte dhe vizita të organizuara në SOA, shtabin qendror të policisë dhe OTC (një agjenci e veçantë përgjegjëse për përgjimin e telekomunikimeve). Gjatë vizitës në OTC, përveç kontrollit nëse kishte ndonjë përgjim që kishte për cak ish-ministrin, disa deputetë e shfrytëzuan rastin për të kontrolluar disa numra të tjerë celularë që nuk kishin lidhje me çështjen. Mediat raportuan se një nga këta numra i përkiste një politikani lokal që ishte me të vërtetë nën një hetim të veçantë, të profilit të lartë. Një numër tjetër telefonik i përkiste një prej anëtarëve të komisionit. Në poteren mediatike që pasoi, deputetët e komisionit akuzuan njëri-tjetrin për shkeljen e standardeve procedurale. Përfundimisht, komisioni i mbikëqyrjes erdhi në përfundimin se ata nuk kishin arritur të përcaktonin ndonjë abuzim, megjithëse deputetët e opozitës u ankuan se nuk ishin mjaft të bindur për të përjashtuar 'lojën e ndyrë' nga policia. Mbi një vit më vonë dhe pas ndryshimit të qeverisë, rrodhi në media një raport i hetimeve të brendshme të policisë duke treguar se ndërsa ish-ministri as nuk kishte qenë nën vëzhgim, as nuk kishte pasur përgjim të telefonit të tij, ai kishte qenë nën hetim penal. Raporti gjithashtu konfirmoi se nuk kishte asgjë të pazakontë në lidhje me hetimin.

Balancimi i të drejtave të privatësisë dhe aftësive efektive të inteligjencës

Qasja në depot gjigante të informacionit digjital dhe të ruajtjes së të dhënave, që janë jetike për sigurinë dhe punën hetimore të agjencive të zbatimit të ligjit është debatuar shumë. Shqetësimet lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale dhe të privatësisë janë të rëndësishme në agjendën e BE-së. Ndarja e të dhënave personale, siç është Regjistri i Emrit të Udhëtarëve (PNR), me rëndësi kaq vendimtare kur ndiqet lëvizja e të dyshuarve për terrorizëm, ishte penguar deri para disa vitesh.¹³ Që nga ajo kohë, zotimi i BE-së për të siguruar kontinentin ka çuar në një legjislacion të harmonizuar për zbatimin e detyruar që merr parasysh mbrojtjen e të dhënave, ndërsa e bën më të lehtë për prokurorët, policinë dhe shërbimet e sigurisë që të bashkëpunojnë në hetimet ndërkuftare për të luftuar në mënyrë më efektive krimin, terrorizmin dhe sulmet kibernetike në mbarë kontinentin. Gjetja e një ekuilibri me vend midis mbrojtjes së privatësisë individuale dhe sigurimit të aftësive efektive të inteligjencës do të jetë objekt i shumë mosmarrëveshjeve në të ardhmen. Zhvendosjet relative në favor të njërit apo tjetrit me gjasë do të përcaktohen nga zhvillimi i ngjarjeve.

Iniciimi i dialogut publik për rolin dhe të ardhmen e inteligjencës

Në Kroaci ende nuk ka ndodhur një diskutim i hapur dhe gjithëpërfshirës publik mbi këtë ekuilibër dhe mbi të ardhmen e inteligjencës në përgjithësi. Pas një çerek shekulli, ne ende po kishim telashe të pajtoheshim me trashëgiminë e epokës komuniste dhe të pasluftës. Mjedisi ynë i polarizuar dhe tejet i ngarkuar politik kishte pak simpati për një institucion si SOA. Isha i bindur se kishte ardhur koha t'i kaloja disa kufij tradicionalisht të ndaluar.

SOA publikoi raportin e saj të parë vjetor publik në 2014. Në atë kohë, ndërsa e dinim se po hynim në një territor të paeksploruar, nuk jam i sigurt se i kishim kuptuar plotësisht të gjitha rreziqet e përfshira. Sidoqoftë, agjencia u lavdërua gjerësisht për hapjen e saj dhe që kishte hedhur dritë mbi një çështje të frikshme. Raporti nënvizoi se SOA është e detyruar me kufizime të qarta legjislative si dhe e kontrolluar nga dega ekzekutive, parlamentare dhe mbikëqyrja civile. Ai gjithashtu ofroi një vlerësim të paklasifikuar të sigurisë dhe disa informacione themelore mbi zhvillimet brenda shërbimit. SOA ka vazhduar të nxjerrë raport publik vjetor.¹⁴

¹³ Këshilli i BE-së adoptoi për PNR në prill 2016, duke lejuar shteteve të tij anëtare një periudhë dy-vjeçare për të përmbushur dhe harmonizuar ligjet, rregulloret dhe dispozitat e tyre të brendshme.

¹⁴ Shih <https://www.soa.hr/en/documents/public-reports/>.

Në përputhje me këtë politikë të re të hapjes, dokumentet që i përkisnin shërbimit të vjetër sekret jugosllav u deklasifikuan dhe u dërguan në Arkivin Kombëtar në 2015. Nuk jam i sigurt pse ky hap nuk ishte ndërmarrë më herët. Ndërsa kjo ngjarje historike do të duhej të shërbejë për të eliminuar skeptikët, me siguri që do të jetë me përfitim edhe për historianët, gazetarët dhe studiuesit akademikë. Ishte gjithashtu një gjest simbolik i synuar në mënyrë implicite për të pasqyruar qasjen tonë të re të pikëpamjes drejt të ardhmes. Ne presim që kjo të ndihmojë në ndërtimin e besimit dhe adresimin e dëshirës legjitime të publikut për qasje në informacion.

SOA gjithashtu ka iniciuar dialogun me ekspertë dhe grupe të shoqërisë civile, veprim ky i njohur nga institucionet e BE-së që promovojnë të drejtat dhe liritë themelore.¹⁵ Në vitin 2014, SOA mbajti tryezën e parë të diskutimit vjetor me përfaqësuesit e grupeve të të drejtave të njeriut dhe organizatave joqeveritare. Ndërsa seria e parë e ngjarjeve, ku unë personalisht mora pjesë, ishte e vështirë ashtu siç pritej, takimet e mëvonshme reflektuan një kuptim të përbashkët të rolit përkatës të secilit aktor. Rezultatet e këtij dialogu përfshijnë rritjen e transparencës dhe më shumë informacion mbi rolin e SOA në raportet e saj vjetore publike. Takime të ngjashme janë mbajtur me media, studentë dhe grupe ekspertësh. Diskutime të tilla të hapura dhe të sinqerta janë dëshmuar të dobishme për të gjithë.

Pikëpamja për të ardhmen: Kuptimi i sigurisë sonë

Pas një raportimi informativ të inteligjencës, e pyeta një operativ të lartë se çfarë po kërkonim të mbledhim. Kjo ishte në ditët e mia të para në agjenci. “Gjithçka”, ishte përgjigja e tij, “gjithçka dhe çka do që mund të kapim me dorë.” Kjo nuk mund të jetë kështu, mendova me vete. Sigurisht, ne nuk kishim gjithë kohën e botës ose resurse të pakufizuara për t’u përpjekur të mbledhim ‘gjithçka’. Më vonë do të inkurajonim Këshillin e Sigurisë Kombëtare që të adoptojë udhëzime me prioritet të caktuara të inteligjencës. Bota përreth nesh me gjasë do të bëhej gjithnjë e më e komplikuar, me sasi të mëdha informacionesh të parëndësishme dhe narrativa konkurruese që frenojnë kapacitetet tona analitike. Aftësia e SOA për të ofruar qartësi dhe mirëkuptim do të ishte një kontribut i paçmueshëm.

Ne po jetojmë gjatë njërit prej transformimeve më mahnitëse të kuptimit tonë të sigurisë. Nga pasiguritë e Luftës së Ftohtë të një lufte bërthamore te interesat e sotme konkurruese kombëtare dhe një sërë sfidash të ndërlikuara transnacionale të sigurisë, ngurroj të sugjeroj që bota është një vend më i sigurt. Kuptimi i ndërlikimeve të një rendi botëror të bazuar në rregulla që po shembet dhe zbërthimi i asaj që po ndodh me të vërtetë është punë e vështirë edhe për analistët dhe njohësit më të mprehtë. Ne i etiketojmë kërcënimet si ‘asimetrike’ ose ‘hibride’ përpara se t’i kuptojmë plotësisht ato dhe vijmë në konkluzione përpara se ta vendosim problemin në kornizën e caktuar. Nëse kufizimet kohore nuk kërkojnë veprim të menjëhershëm, marrja e kohës për ta kuptuar një çështje është kohë e kaluar me mend. Librat e historisë janë plot gabime trashanike të inteligjencës bazuar në perceptime të gabuara, llogaritje të gabuara ose gjykime të gabuara.

Vlerësimi i sigurisë së një kombi është punë shumë serioze. Ka shumë pasiguri dhe shumë mënyra për të gabuar në këtë vlerësim. Dorëzimi ndaj ndjenjave tona ose animeve personale na bën të arrijmë në përfundime të dobëta. Nxitja nga autoritetet më të larta për të arritur në përfundime të shtrembëruara që mbështesin një histori të paracaktuar do të duhej të jetë po aq shqetësuese. Është shumë e rëndësishme të njihen këto gracka.

Rëndësia e vlerësimit të saktë të perceptimeve tona

Të gjitha fillojnë me, dhe shumëçka varet nga, perceptimet tona. Ekspertët tanë të inteligjencës skanojnë rrethinën tonë, interpretojnë atë që po ndodh dhe vlerësojnë rreziqet, kërcënimet dhe sfidat. Perceptimet e tyre kanë rëndësi. Ne mbështetemi tek ata që të jenë të ditur, të paanshëm dhe, mbi të gjitha, të saktë. Ato që ne i perceptojmë si kërcënime ndaj sigurisë sonë kombëtare, reale ose imagjinare, do të jenë reale në veprimet dhe reagimet e qeverisë sonë. Prandaj, supozimet, llogaritjet dhe konkluzionet tona gjithmonë do të duhej t’i nënshtrohen një shoshitjeje të plotë.

Agjencia jonë ka për detyrë të luftojë terrorizmin, trafikimin e paligjshëm (të migrantëve, armëve dhe narkotikëve), korrupsionin, veprimtarinë kriminale transnacionale dhe komplekse, radikalizmin dhe ekstremizmin. Kërcënimet kibernetike, migrimi masiv dhe përhapja e armëve të shkatërrimit në masë, si dhe shqetësimet mbi mirëqenien tonë ekonomike, mbrojtjen e infrastrukturës kritike dhe sigurinë energ-

15 Shih “Surveillance by intelligence services: fundamental rights safeguards and remedies in the EU, Mapping Member States’ legal frameworks,” FRA - European Union Agency for Fundamental Rights, 2015, f. 32.

jetike, gjithashtu mbushin listën në rritje të detyrave që politikëbërësit tanë presin që ne t'i trajtojmë. Jo më pak shqetësuese janë rreziqet që paraqesin shërbimet armiqësore të inteligjencës të përfshira në spiunazh. Gjithnjë e më shumë, kundërshtarët tanë po përpiqen të vjedhin informacione të klasifikuara ose sekrete industriale ose po orvaten të ushtrojnë ndikim në politikën dhe opinionin publik në favor të tyre. Disa nga këto sfida mund të jenë mjaft të diskutueshme.

Agjencia e Sigurisë dhe Inteligjencës (SOA) e Kroacisë

- Rrënjët e SOA datojnë në kohën e shpërbërjes së trazuar dhe të dhunshme të Jugosllavisë në fillimin e viteve 1990, meqë inteligjenca luajti rol të rëndësishëm në luftën e Kroacisë për pavarësi (1991-1995).
- Pas disa raundeve të ristrukturimit, SOA u krijua më 2006 me bashkimin e Agjencisë së Kundërzbulimit (POA) dhe Agjencisë së Inteligjencës (OA).
- Në shërbim të qëllimeve të inteligjencës së huaj dhe të sigurisë së brendshme, ajo e ka selinë në Zagreb, zyra rajonale në të gjithë vendin dhe stacione jashtë vendit.
- Misioni i SOA është të “zbulojë, hetojë dhe kuptojë kërcënimet dhe sfidat e sigurisë duke mbledhur dhe analizuar informacione të rëndësishme për sigurinë kombëtare, duke i ofruar kështu udhëheqjes së shtetit dhe organeve të tjera shtetërore mbështetje të besueshme të inteligjencës në vendim-marrje dhe duke vepruar në mbrojtje të sigurisë kombëtare, interesave të Kroacisë dhe mirëqenies së qytetarëve të saj.” (Burimi: SOA)
- Detyrat e saj kryesore përfshijnë kundërvënien ndaj terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm, kundërzbulimin, luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit, sigurinë kibernetike, mbrojtjen e informacionit të klasifikuar, kryerjen e verifikimeve të sigurisë dhe mbledhjen e inteligjencës së huaj.
- Sipas raporteve të mediave, madhësia e personelit të saj vlerësohet të jetë midis 900 dhe 1000 punonjës.
- Buxheti i SOA për 2020 është rreth 55 milionë euro.

Për më shumë informacion, vizito uebsajtin zyrtar të SOA këtu <https://www.soa.hr/en/about-us/>.

Kur përzihen krimi, korrupsioni dhe politika

Krimi, korrupsioni dhe politika mund të ndërthuren pazgjidhshmërisht për të krijuar një dilemë të frikshme. Situata mund të komplikohet më tej nga përfshirja e politikanëve të rangut të lartë ose individëve me ndikim. Ndërsa shërbimet e brendshme të sigurisë, si rregull e përgjithshme, nuk do të duhej të kryejnë hetime penale, ka përjashtime kur një situatë paraqet rrezik të qartë dhe të ngutshëm për rendin demokratik.¹⁶ Situatat e tilla mund të mos jenë gjithmonë të vetëkuptueshme. Ndonjëherë zyrtarë të lartë të sigurisë thirren të marrin vendime të vështira ‘hip se të vrava, zbrit se të mbyta’. Nga ana tjetër, shërbimet e sigurisë gjithashtu mund të dalin lehtësisht nga binarët dhe, para se dikush ta kuptojë, papritmas e gjejnë veten në një pozitë komprometuese.

Të kesh një kuptim të shëndoshë të sigurisë, udhëzime të qarta të inteligjencës dhe rregulla të përku-fizuara mirë për angazhim mund të ndihmojnë në drejtimin e menaxhmentit të lartë në kahun e duhur.

Vlerësimi i fleksibilitetit të vetishëm të sigurisë kombëtare

Nocioni i sigurisë kombëtare është aq vetiu fleksibël saqë, nëse shtrihet mjaftueshëm, ai lehtë mund të përputhet me një rrëfim që i shërben vetvetes. Në të kaluarën, shërbimet sekrete gëzonin kompetenca gjerësisht të pakontrolluara. Shërbimi sekret jugosllav ishte famëkeq për rekrutimin e kriminelëve që kanë kryer krime të rënda për të bërë punën e tyre të ndyrë jashtë vendit. Dhjetëra disidentë dhe

16 Asambleja Parlamentare, Raport i Komisionit për Çështje Ligjore dhe të Drejtat e Njeriut, Këshilli i Evropës, “Control of internal security services in Council of Europe member states”, Dokumenti 8301, 23 mars 1999.

armiq të tjerë të regjimit u vranë jashtë vendit nga këta banditë me pagë. Ndonjëherë atentatet ishin qëllimisht brutale dhe të tmerrshme. Shumë nga këto marrëdhënie kriminale mbetën të paprekura edhe pas shpërbërjes së ish-Jugosllavisë dhe kalimit në demokraci. Kontrabandimi i paligjshëm, marrëveshjet e diskutueshme të biznesit, tenderët e kurdisur publikë dhe skemat e korruptuara të privatizimit shpesh ndodhnin nën mbrojtjen dhe vëzhgimin e shërbimeve sekrete.

Problemi mund të bëhet edhe më akut në rastet e korrupsionit sistemik dhe 'kapjes së shtetit'. Krimi, korrupsioni, politika dhe shërbimet sekrete bëhen praktikisht të padallueshëm. Në raste të tilla, duhet përpjekje e jashtëzakonshme për të rivendosur rendin dhe shtetin e së drejtës.

Mbrojtja e cenueshmërive tona të reja

Ndërveprimi i novacioneve teknologjike dhe rrjeteve sociale kërkon vëmendje të veçantë. Navigacioni nëpër epokën e 'të vërtetave nga postimet', 'lajmeve të rreme' dhe 'luftimeve me informacione' nuk do të jetë punë e lehtë. Më shumë se kurrë, do të duhet të pyesim veten nëse i kemi aftësitë e duhura.

Zhvillimet teknologjike i kanë bartur me shpejtësi shoqëritë tona në një territor të paeksploruar dhe kryesisht të parregulluar të mundësive dhe cenueshmërive të reja dinamike. Jeta private e qytetarëve tanë, ekonomitë tona dhe shërbimet tona thelbësore, qoftë financat, shëndetësia, energjia apo transporti, të gjitha varen gjithnjë e më shumë nga teknologjitë digjitale të informacionit dhe komunikimit. Kjo ka ndryshuar rrënjësisht shoqërinë tonë, nga mënyra se si bëjmë biznes deri te mënyra se si ndërveprojmë me njëri-tjetrin. Ata që kanë qëllime armiqësore e kanë gjithnjë e më të lehtë të prishin mënyrën tonë të jetesës. Një sulm i thjeshtë kibernetik ndaj ofruesve të shërbimeve publike ose komerciale mund të rezultojë në pasoja të rrezikshme dhe çrregulluese, duke filluar nga trazirat publike deri te dëmtimet serioze ekonomike dhe madje mund të rrezikojnë jetën.

Si një fushë që gradualisht po zë vend qendror, hapësira kibernetike tani është në mënyrë të palëkundur në shënjestër të vëmendjes së agjencive të zbatimit të ligjit dhe inteligjencës. Me ndërlikimet dhe paqartësitë e saj të vetishme, siguria kibernetike me siguri do të dominojë agjendën tonë, do të konsumojë resurset tona dhe do të gjenerojë polemika të reja. Ne nuk mund të lejojmë të na zë të papërgatitur.

Sfidat jotradicionale dhe dukuritë komplekse

Nëse kjo nuk do të mjaftonte për të na shqetësuar, çfarë roli, nëse ka ndonjë, do të luajnë shërbimet e sigurisë dhe inteligjencës ndërsa shoqëritë tona gjithnjë e më shumë përballen me rreziqet e sëmundjeve infektive (pandemitë), ndryshimeve klimatike, degradimit të mjedisit dhe fenomeneve të tjera komplekse? Ne nuk mund thjesht t'i hedhim poshtë sfidat e tilla. Ndërsa ato bien jashtë kompetencave tona tradicionale, këto rreziqe janë pjesë e një konteksti më të gjerë të sigurisë dhe sjellin pasoja serioze politike, sociale dhe ekonomike. Shpërfillja e fenomeneve të tilla rrezikon ta shtyjë inteligjencën drejt parëndësisë. Shërbimet e sigurisë që i injorojnë këto sfida, pa kërkuar të fitojnë të paktën një kuptim themelor të tyre, e bëjnë këtë në kurrizin e vet.

Përfundimet


Vendet e Evropës Lindore, nga Baltiku në Ballkan, si dhe vendet e ish-Bashkimit Sovjetik, janë përballur shkel e shko me perspektivat e reformave të inteligjencës në tranzicionet e tyre demokratike. Shumë, si Kroacia, janë përpëlitur mjaft kohë pas përfundimit të Luftës së Ftohtë. Megjithatë, secili është në një pozicion unik për të formuar shtrirjen dhe dinamikën e reformave të veta të inteligjencës. Dhe nuk ka asnjë garanci se kjo do të jetë një sipërmarrje e këndshme ose pa rreziqe. Secili duhet të pajtohet me të kaluarën e vet, të përbushë kërkesat e tij aktuale, të menaxhojë pritjet dhe të përqafojë potencialin e tij të ardhshëm. Në ndërkohë, bota po ndryshon vazhdimisht, ndërsa supozimet e vjetra dëshmohen se nuk janë të besueshme dhe shfaqen sfida të reja. Ky mund të jetë akt delikat baraspeshimi që kërkon vullnet dhe zotim të ndjeshëm politik.

Përvoja e Kroacisë ofron disa njohuri dhe mësim të rëndësishme. Reformat e inteligjencës janë të vazhdueshme dhe kërkojnë përpjekje afatgjata. Për më tepër, një matje e besueshme e qeverisjes efektive është prova e kohës. Në praktikë, mbikëqyrja parlamentare ende nuk e ka hequr qafësh politikën partiake. Dëshira e Kroacisë për t'u bashkuar me NATO-n dhe BE-në ofroi nxitje të fortë për të mbjellë

parime të bazuara në vlerat e përbashkëta të demokracive perëndimore. Gjatë rrugës, ne shpejt i kuptuam përfitimet nga llogaridhënia, mbikëqyrja dhe masat mbrojtëse kundër abuzimit. Konkretisht, aftësitë e SOA janë përmirësuar, vetëbesimi në radhët e tij është rritur dhe mbështetja e publikut është rritur. Publikimi i raportit të saj të parë të paklasifikuar rezultoi në një rritje të jashtëzakonshme të kërkesave për punësim në SOA. Kjo ishte dëshmia se adoptimi i parimeve të qeverisjes së mirë përkthehet në ndërtimin e kapaciteteve.

Ekziston gjithashtu një aspekt strategjik, dhe mbase sipërmarrës, në transformimin e SOA. Ajo ka adoptuar mendësinë e korporatave në qasjen e saj ndaj shërbimit publik. Agjencia ka ndërmarrë vetë-vlerësimin si bazë për zhvillimin e saj strategjik, gjë që nuk është përpjekje e parëndësishme për një organizatë të inteligjencës. SOA mori lavdërime unanime ndër-partiake për planin e saj strategjik të zhvillimit në komisionin parlamentar të mbikëqyrjes së inteligjencës. Agjencia është më e aftë të njohë me kohë kërcënimet që dalin dhe luan rol prijës në përpjekjet tona kombëtare të sigurisë kibernetike. Por, siç tregohet me krenari në raportin e saj publik të vitit 2019, arritja më mbresëlënëse e SOA është zotimi i saj i vazhdueshëm (që nga viti 2012) për të rritur çdo vit investimet në modernizim dhe zhvillim.

Reformat e SOA kanë ecur paralelisht me tranzicionin demokratik dhe integrimin Euro-Atlantik të Kroacisë. Anëtarësia e agjencisë dhe roli aktiv në forumet kryesore ndërkombëtare, si dhe bashkëpunimi i saj i ngushtë me shërbimet e sigurisë dhe inteligjencës të demokracive perëndimore të një mendjeje, i ofrojnë asaj mundësi të zmadhuara për të përmbushur në mënyrë efektive misionin e saj. Kjo gjithashtu dëshmon për progresin e dukshëm të SOA për dekada të tëra. Me një kapacitet mbikëqyrës të pjekur dhe transparencë më të madhe, SOA është në gjendje më të mirë për të zhvilluar aftësitë e nevojshme për adresimin e sfidave të ardhshme të sigurisë me të cilat do të përballet.





DCAF Qendra e Gjenevës
për Qeverisjen e
Sektorit të Sigurisë

20 VJETORI

DCAF Geneva
Headquarters

P.O.Box 1360
CH-1211 Geneva 1
Switzerland

✉ info@dcaf.ch
☎ +41 (0) 22 730 9400

www.dcaf.ch

🐦 @DCAF_Geneva